



REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIKA E KOSOVËS	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË - MINISTARSTVA ZDRAVSTVA	
SHËRBIMI SPITALOR DHE KLINIK UNIVERSITAR I KOSOVËS (SHSKUK)	
BOLNIČKA I KLINIČKA UNIVERZITETSKA SLUŽBA KOSOVA (BKUSK)	
THE HOSPITAL AND UNIVERSITY CLINICAL SERVICE OF KOSOVO (HUCSK)	
PRISTINE - PRISTINA - PRISTINA	
No. of pages orig. pag. orig. pag.	No. Prot. Bord. prot. Prot. No.
No. of pages orig. pag. orig. pag.	Date Datum Date
2	857 31.01.25

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstva Zdravstva - Ministry of Health

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK)

Bolnička i Klinička Univerzitetska Sluzba Kosova (BKUSK)

The Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)

Nr:02/2025

Datë: 31.01.2025

Prishtinë

Bazuar në Nenin 64 të Ligjit Nr. 04./L-125 për Shëndetësi, Nenin 53 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Nenin 14, Nenin 15 dhe Nenit 16 të Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK) dhe Rregullores Nr.01/2024 të Punës të Bordit Drejtues të SHSKUK-së, Bordi Drejtues i SHSKUK-së mori:

V E N D I M

1. Shfuqizohet Vendimi i Bordit Drejtues të SHSKUK-së me Nr.Prot: 1024, Datë:08.04.2024.
2. Shfuqizohet Rregullorja Nr.02/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës me Nr.Prot: 1024, Datë:08.04.2024.
3. OBLIGOHET Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Bordi Drejtues i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, duke u bazuar në Nenin 64 të Ligjit Nr.04/L-125 për Shëndetësi, Nenit 17 Par.2 të Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, me datë 08.04.2024 ka miratuar Rregulloren Nr.02/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës këtu e tutje Rregullorja. Kjo rregullore kishte për qëllim përcaktimin e organizimit të brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Administratën e Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës këtu e tutje SHSKUK. Duke u nisur nga organizimi i SHSKUK, Rregullorja synonte rregullimin e vendeve të punës në kuadër të administratës qendrore të SHSKUK-së dhe të gjitha njësive përbërëse të saj.

Me rastin e hyrjes në fuqi të Rregullores, SHSKUK ka pranuar Aktvendimin A.nr.1795/2024 të datës 14.05.2024 nga Gjykata Themelore në Prishtinë me anë të të cilit është shtyrë ekzekutimi i Rregullores, SHSKUK ankimon

këtë Aktvendim dhe me datë 08.07.2024 SHSKUK pranon Aktvendimin AA.nr.573/2024 nga Gjykata e Apelit e Kosovës e cila konfirmon Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe si përfundim shtyhet ekzekutimi i Rregullores. SHSKUK, brenda afatit ligjor e përmes mjetit të jashtëzakonshëm juridik e ankimon Aktvendimin e Gjykatës së Apelit në Gjykatën Supreme të Kosovës e cila përfundimisht më 04.09.2024 përmes Aktvendimit ARJ.nr.120/2024 konfirmon vendimin e Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës së Apelit dhe si rrjedhojë e kësaj procesi Rregullorja nuk mund të zbatohet deri në vendim meritore nga Gjykata.

Bordi Drejtues si organi më i lartë vendimmarrës në SHSKUK, duke qenë në këtë situatë dhe këto rrethana, krahas detyrimeve dhe përgjegjësiave ligjore të cilat derivojnë nga Ligji Nr.04/L-125 për Shëndetësi, Statuti i SHSKUK-së, Rregullorja e Punës së Bordit dhe legjislati i përkatës në fuqi si dhe obligimeve ndaj qytetarëve në kujdesin shëndetësor dhe ofrimin e shërbimeve shëndetësore ka analizuar me kujdes situatën dhe këtë gjendje, po ashtu duke qenë të vetëdijshëm për kohëzgjatjen e procesit gjyqësor e që duke u nisur nga praktika kjo kohëzgjatje është mjaft e gjatë dhe SHSKUK nuk mund të funksionojë kaq gjatë pa Rregullore e cila përcakton vendet e punës, SHSKUK nuk mund t'i ushtrojë kompetencat e saj si dhe nuk do të mund të përmbush mandatin ligjor. Po ashtu duke pasur parasysh që Rregullorja nuk ka gjetur zbatim pasi që e njëjta menjëherë është pezulluar nga Gjykata dhe nuk është ndërmarrë asnjë veprim nga ana e SHSKUK-së e gjithashtu duke e ditur që të gjithë paditësit marrëdhëniet e tyre të punës i kanë me njësitë përbërëse të SHSKUK-së dhe kërkesa e tyre e vetme drejtuar Gjykatës është anulimi i kësaj Rregullore.

Prandaj, Bordi Drejtues në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tij, ka vendosur që të shfuqizojë vendimin Nr.Prot: 1024 të datës 08.04.2024 me të cilin ka miratuar Rregulloren Nr.02/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, gjithashtu Rregulloren Nr.02/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës dhe të fillojë procedurën për hartimin e një drafti tjetër të rregullores e cila do të rregullojë vendet e punës në administratën qendrore të SHSKUK-së veç ndërsa vendet e punës në kuadër të njësive përbërëse të SHSKUK-së do të rregullohet me akte tjera të veçanta.

Andaj, siç u tha më lart u vendos si në dispozitiv të kësaj vendimi.

Dr. Dren BOSHNIJAKU

Kryesues i Bordit Drejtues të SHSKUK-së

Iu dërgohet:

- Anëtarëve të Bordit Drejtues,
- Sekretarit të Bordit Drejtues,
- Drejtorit të Përgjithshëm të SHSKUK-së,
- Departamenti Ligjor – SHSKUK,
- Arkivit të SHSKUK-së.